

Nëntor 2025 | Nr. 54

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i Drejtësisë



@ILD_Albania



Inspektori i Lartë i Drejtësisë

**PJESËMARRRËS TË EDICIONIT TË III-TË TË AIEN,
VIZITË STUDIMORE NË ILD**



Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" | Godina nr.13 | Tiranë, Shqipëri



PJESËMARRËS TË EDICIONIT TË III-TË TË AIEN, VIZITË STUDIMORE NË ILD

Pjesëmarrës të Akademisë së Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN) zhvilluan një vizitë studimore në ambientet e ILD-së, që parashikonte një bashkëbisedim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani, në kuadër të modulit “Shteti i së drejtës” dhe një vizitë në ambientet e ILD-së.

Pjesëmarrësit e kësaj akademie, të angazhuar në administratën publike, institucione jo publike, organizata të shoqërisë civile, juristë e profesionistë të fushave të tjera, u njohën nga z. Metani me rolin dhe funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, proceset e punës dhe sfidat e institucionit, si forcimin e shtetit të së drejtës, ashtu edhe rritjen e besimit të publikut tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë në vecanti dhe sistemi i drejtësisë në përgjithësi.

Takimi vijoi si një bashkëbisedim i hapur mbi sfidat e sistemit të drejtësisë dhe rolin specifik të ILD-së në adresimin e tyre. Inspektori i Lartë i Drejtësisë e vuri theksin tek rëndësia që institucioni i jep respektimit të pavarësisë së magjistratëve dhe balancës me llogaridhënien e tyre, krahas edukimit ligjor, përmes aktiviteteve e takimeve me grupe të ndryshme shoqërore.

Në fund të bashkëbisedimit, pjesëmarrësit e Akademisë së Integritimit Evropian dhe Negociatave zhvilluan një tur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, tek njësitë e Inspektorëve e ndihmës inspektorëve, kabineti dhe administrata e institucionit.

FOTO NGA AKTIVITETI





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË, PRAKTIKA E EDUKIMIT LIGJOR

Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka kushtuar një vëmendje të veçantë edukimit ligjor të publikut me fokus rritjen e besimit të publikut tek drejtësia. Grupet e synuara për edukimin ligjor janë ato të cilat kanë shfaqur nevojë më të madhe për t'u njohur me garancitë kushtetuese dhe ligjore, siç janë nxënësit e shkollave të mesme dhe universiteteve, aktivistët e shoqërisë civile e të tjerë. Edukimi ligjor i publikut konsiston në përçimin e njohurive ligjore tek qytetarët dhe në rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për rëndësinë e zbatimit të ligjit.

Qytetarët që kuptojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ligji, mbrohen më mirë në situatat me të cilat përballen në jetën e

përditshme. Pajisja e qytetarëve me njohuri ligjore i bën ata më aktivë në mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve publike. Qytetarët e ndërgjegjësuar për rëndësinë e ligjit kontribuojnë në forcimin e kulturës së zbatimit të ligjit.

Për të realizuar këtë objektiv, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar një program të posaçëm për edukimin ligjor dhe përgatitur e publikuar materiale informuese (ftelëpalosje, materiale audiovizuale) në gjuhë të thjeshtë për publikun, përmes të cilave shpjegohet funksionimi i institucioneve të drejtësisë, procedurat që duhet ndjekur për t'iu drejtuar institucioneve dhe të drejtat e qytetarëve. Këto materiale janë shpërndarë kryesisht

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar një program të posaçëm për edukimin ligjor dhe përgatitur e publikuar materiale informuese (ftelëpalosje, materiale audiovizuale) në gjuhë të thjeshtë për publikun, përmes të cilave shpjegohet funksionimi i institucioneve të drejtësisë, procedurat që duhet ndjekur për t'iu drejtuar institucioneve dhe të drejtat e qytetarëve. Këto materiale janë shpërndarë kryesisht përmes faqes zyrtare të institucionit dhe media-ve sociale, si një mënyrë e drejtpërdrejtë për të siguruar akses në informacion të saktë dhe të kuptueshëm për cdo qytetar të interesuar.

përmes faqes zyrtare të institucionit dhe mediave sociale, si një mënyrë e drejtpërdrejtë për të siguruar akses në informacion të saktë dhe të kuptueshëm për cdo qytetar të interesuar.

Në këtë dimension pune, edukimi ligjor i publikut përmbush disa funksione.

Së pari, i shërben aftësimin juridik të qytetarëve për të shmangur konfliktet me ligjin apo për t'i zgjidhur këto konflikte gjyqësisht, duke pasur tashmë kuptim më të mirë të të drejtave dhe detyrimeve dhe mbi të gjitha duke ditur, se ku mund të drejtohen për të kërkuar ndihmë. Në këtë mënyrë garantohet qasja në drejtësi e qytetarëve, që përbën një nga shtyllat mbi të cilat mbështetet shteti i së drejtës.

Së dyti, në funksion të synimit për të komunikuar me grupe interesi edhe nëpër rrethe, që nga gjyqet imituese në shkolla e deri tek tryezat e bashkëbisedimit me Organizatat e Shoqërisë Civile.

Komunikimi i hapur në këto tryeza, me vetë

Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, inspektorë dhe përfaqësues të drejtorive të institucionit, nxori në pah rëndësinë që ka paraqitja e institucionit tek grupet e ndryshme të interesit, aty ku ata jetojnë dhe diskutimet mbi mënyrën se si e shohin rolin e institucionit, eksperiencat dhe pritshmëritë në raport me sjelljen e magjistratëve në sistem.

Aksesi i publikut në njohuritë mbi ligjin është themelor për garantimin e një sistemi drejtësie efektiv. Kështu, informimi dhe dhënia e njohurive për ligjin, mbi të drejtat, institucionet ligjzbatuese, përgjegjësitë etj, nuk janë të lidhura vetëm me arsimimin juridik, por janë përbërësit e kulturës dhe nevojës qytetare për qasjen ndaj shtetit të së drejtës. Nëpërmjet përfatimit të njohurive ligjore, si dhe rritjes së sigurisë që qytetarët ndjejnë në përdorimin e ligjit, edukimi ligjor i publikun kontribuon edhe në forcimin e qytetarisë aktive dhe në një kohezion më të madh shoqëror.



MATURANTË TË GJIMNAZIT “SAMI FRASHËRI” VIZITË NË ILD

Maturantë të klasës së drejtësisë të gjimnazit “Sami Frashëri” zhvilluan një vizitë mësimore në ILD, në kuadër të informimit përmes edukimit ligjor, një dimension pune, që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë e praktikon në vijimësi.

Maturantët zhvilluan një bashkëbisedim me inspektoren jomagjistrate znj. Joana Sorraj, e cila i njohu me objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, rolin, funksionet, proceset e punës, si dhe sfidat e institucionit, për rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë dhe të besimit të publikut tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si një nga institucionet e reja të krijuara nga Reforma në Drejtësi.

Gjimnazistët u informuan në detaje me mënyrën si bëhen ankesat, kush ka të drejtë të drejtojë një ankesë në ILD dhe nëse mundet vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë të vihet në lëvizje për të nisur një procedurë disiplinore.

Inspektorja Joana Sorraj, e shoqëruar nga përgjegjësi i sektorit të ankesave dhe marrëdhënieve me publikun Elis Kuçi dhe specialistja Zilije Feçi, iu përgjigj interesit të gjimnazistëve, që aspirojnë vijimin e studimeve për drejtësi, për proceset e punës së inspektorëve, afatet e shqyrtimit të ankesave, pranueshmërinë e një ankese dhe pozicionin e magistratit ndaj të cilit bëhet ankesë, gjatë një hetimi e procedimi disiplinor.



Inspektorja Joana Sorraj e vuri theksin tek rëndësia që institucioni i jep respektimit të pavarësisë së magistratëve, balancës me llogaridhënien e tyre, si dhe interesit legjitim të qytetarëve për mënyrën sesi administrohet drejtësia.

Bashkëbisedimi është pjesë e aktiviteteve, që

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvillon në institucion apo edhe jashtë tij, me grupe të ndryshme shoqërore në kuadër të informimit publik përmes edukimit ligjor, që konsiston në përçimin e njohurive ligjore dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e zbatimit të ligjit.





KLP NUK PRANON KËRKESËN E ILD PËR MASË DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATES B.S

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka rrëzuar kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj magjistrates B. S., me detyrë Prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar hetimin disiplinor në bazë ankese nga drejtuesi i Prokurorisë, ndaj prokurores B. S., për shkeljen disiplinore të parashikuar, si “Shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet... me kryetarin...si dhe me personelin e administratës gjyqësore.”, gjatë vitit 2024.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë hetimit disiplinor rezultoi se veprimet e magjistrates B. S. në marrëdhënie me drejtuesin dhe anëtarë të personelit të administratës gjyqësore përbëjnë sjellje të padenja, të pahijshme, pa vetëpërmbytje, në kundërshtim me Standardet e Etikës e në shkelje të parimit të garantimit të besimit të publikut tek drejtësia.

Shkeljet e konstatuara nuk lidhen me veprimtarinë e saj profesionale, e mund të jenë të rëndësishme vetëm me qëllim vlerësimin etik dhe profesional të saj, por janë të natyrës, që magjistratja duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore.

Nga hetimi i ILD-së rezultoi se sjellja dhe veprimet e prokurores, kryer me dashje direkte kanë sjellë si pasojë diskreditim të pozitës dhe figurës së magjistratit, si dhe cenim të besimit të publikut te drejtësia.

mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe 2- parandalimin e përgjithshëm, d.m.th. që magjistratët e tjerë të kuptojnë, se një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

Kjo sjellje është kryer në zyrën e drejtuesit të prokurorisë, si dhe në zyrat ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre oficerë të policisë gjyqësore, duke passjellë rrezikun që kjo sjellje të ndiqet edhe nga magjistratët e tjerë të së njëjtës zyre prokurorie apo dhe më gjerë, pasi brenda së njëjtës godinë ndodhet edhe gjykata, çfarë nënkupton rëndësinë thelbësore që ka sjellja e magjistratit jo vetëm në ambientet e prokurorisë, por dhe jashtë saj.

Duke pasur parasysh natyrën e shkeljes disiplinore dhe ekzistencën e rrethanës lehtësuese, si shkelje për herë të parë, përvojën e pakët 2 vjeçare të magjistrates në funksionin e prokurores, ILD konkludon se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga magjistratja B.S., përbëjnë “Shkelje të lehtë disiplinore” dhe i propozoi Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj prokurores B.S., për shkeljen disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 2 shkronja “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Kërkesa u rrëzua nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Në raportin hetimor të ILD-së vërehet se qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit dhe marrja e masave aktive për edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Masa disiplinore përmbush edhe dy qëllime parandaluese: 1- parandalimin e posaçëm, pra që magjistrati në të ardhmen të

Në raportin hetimor të ILD-së vërehet se qëllimi thelbësor i masës disiplinore është mbrojtja e interesit publik nëpërmjet deklarimit të përgjegjësisë disiplinore të magjistratit dhe marrja e masave aktive për edukimin e magjistratit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Masa disiplinore përmbush edhe dy qëllime parandaluese: 1- parandalimin e posaçëm, pra që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe 2- parandalimin e përgjithshëm, d.m.th. që magjistratët e tjerë të kuptojnë, se një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

NËNTORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Nëntor 2025** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **106 ankesa nga ta cilat 102 të depozituara nga qytetarë dhe 4 (katër)** nga institucione. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Nëntor 2025**.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR	INSPEKTIVE TEMATIKE
58 vendime nga 97 praktika të trajtuara: 41 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar - 17 vendime arkivimi pas verifikimit	8 vendime verifikimi	2 vendime për fillim hetimi disiplinor për 2 magjistratë (1 gjyqtare, 1 prokuror) - 1 vendim për mbyllje hetimi disiplinor për 1 magjistrat (gjyqtare)	1 (Një) "Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastër, për periudhën 01.04.2024-30.06.2024"

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13, Tiranë.
- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD,


në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin "**Si pranohen ankesat**".

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Nëntor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, **për 5 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit **Nëntor 2025**,
Sektori i Ankesave dhe
Marrëdhënieve me Publikun:

- ⇒ **ka pritur 37 ankues**,
të cilët janë paraqitur në ambi-
entet e Zyrës së Inspektorit të
Lartë të Drejtësisë;
- ⇒ **ka realizuar 23 telefonata me**
qytetarë, të cilët kanë
kërkuar informacion mbi
fazën e ankesave të tyre ose
Informacion mbi plotësimin e
formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohet nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: **info@ild.al**, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit **amanta.jasa@ild.al**.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit **Nëntor 2025**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **22 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ILD NË TWITTER



@ILD_Albania


Kënaqësi bashkëbisedimi me profesionistë të rinj, të motivuar e të vëmendshëm për shtetin e së drejtës!
#ILD #edukimligjor #AIEN 📌



📌 Përpunimi javor i ankesave në #ILD ⚖️

- ✅ 8272 të konfirmuara
- ✅ 6286 të trajtuara
- ✅ 1986 në proces trajtimi
- ✅ 123 në proces verifikimi
- ✅ 142 magjistratë të hetuar
- ✅ 53 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni patur eksperiencë me ne? Na shkruani 📌
ild.al/sq/ankete/



Sot patëm vizitorë shumë interesantë në #ILD ⚖️ Të rinj të interesuar për fushën e së drejtës. #edukimligjor #gjimnaziSamiFrashëri #ILD 📌




Si gjithmonë kënaqësi e veçantë të mikpres në #ILD ⚖️, Dekanin Avni Puka dhe kolegët e tij të @UpJuridik të Universitetit të Prishtinës. Një bashkëpunim sa profesional aq edhe njerëzor mes dy institucioneve tona. 🇲🇰 🇪🇪 🇫🇷



📌 Përpunimi javor i ankesave në #ILD ⚖️

- ✅ 8292 të konfirmuara
- ✅ 6305 të trajtuara
- ✅ 1987 në proces trajtimi
- ✅ 116 në proces verifikimi
- ✅ 142 magjistratë të hetuar
- ✅ 53 kërkesa për procedim disiplinor

? A keni pasur eksperiencë me ne? 📌
ild.al/sq/ankete/



📌 Përpunimi javor i ankesave në #ILD ⚖️

- ✅ 8349 të konfirmuara
- ✅ 6340 të trajtuara
- ✅ 2009 në proces trajtimi
- ✅ 114 në proces verifikimi
- ✅ 144 magjistratë të hetuar
- ✅ 53 kërkesa për procedim disiplinor

? Keni patur eksperiencë me ne? Plotësoni anketën 📌
ild.al/sq/ankete/



Nëntor 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al

Tel: +35542217217

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD

Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin
prezantues të ILD*



Më skano!